



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2021:094794
Datë: 24.05.2024
Numri i dokumentit: 05731407

K.DH.SH.II.nr.650/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Ramush Bardiqi, në çështjen përmbaremore të kreditorit Banka Credins sh.a, me seli ne Tiranë rr.”Vaso Pasha” nr.8 Republika e Shqipërisë te cilin sipas autorizimit e përfaqëson Editon Osmani avokat nga Prishtina, rr.”Sylejman Vokshi” H19, nr.4, ndaj debitorëve: Shoqëria Tregtare N.T.P “Labi-Petroll” me nr. Biznesi 70065503, me adresë ne fshatin Dubravë Komuna e Suharekës, A.G. nga fshati Dubravë Komuna e Suharekës, dhe R.B. nga Suhareka te cilët in përfaqëson sipas autorizimit Arlind Jupolli avokat nga Prishtina si dhe D.B. nga Suhareka, me bazë juridike përmbaremore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorëve Shoqëria Tregtare N.T.P “Labi-Petroll” me nr. Biznesi 70065503, me adresë ne fshatin Dubravë Komuna e Suharekës dhe R.B. nga Suhareka, e ushtruar përmes te autorizuarit të tyre, kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale te Kosovës- Dhomat e Shkalles se Parë –Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.109/23 dt.29.09.2023, me datë 24.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Aprovohet e themeltë ankesa e debitorëve Shoqëria Tregtare N.T.P “Labi-Petroll” me nr. Biznesi 70065503, me adresë ne fshatin Dubravë Komuna e Suharekës dhe R.B. nga Suhareka te cilët i përfaqëson sipas autorizimit Arlind Jupolli avokat nga Prishtina, anulohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale te Kosovës- Dhomat e Shkalles se Parë –Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.109/23 dt.29.09.2023 dhe lënda i kthehet Gjykatës Komerciale-Dhomës se Shkalles se Parë, në rishqyrtim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale te Kosovës- Dhomat e Shkalles se Parë – Departamenti për Çështje Ekonomike me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.109/23 dt.29.09.2023, ne pjesën e I te dispozitivit te aktvendimit ka refuzuar si te pabazuar prapësimin e debitorëve N.T.P “Labi-Petroll” me nr. Biznesi 70065503, me adresë ne fshatin Dubravë Komuna e Suharekës dhe R.B. nga Suhareka, te ushtruar kundër Urdhrit për përmbaremore, P.nr.241/21 dt.06.04.2021, i lejuar nga Përmbareuesi Privat Ilir Mulhaxha me seli ne Prishtinë, ndërsa ne pjesën II te dispozitivit te aktvendimit ka

obliguar debitorët N.T.P “Labi-Petroll” me nr. Biznesi 70065503, me adresë ne fshatin Dubravë Komuna e Suharekës dhe R.B. nga Suhareka qe t’ia paguajnë ne mënyrë solidare kreditorit shumen prej 468.00 euro ne emër te përpilimit te përgjigjes ne prapësim, ne afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktvendimi.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor kanë ushtruar ankesë debitorët Shoqëria Tregtare N.T.P “Labi-Petroll” me nr. Biznesi 70065503, me adresë ne fshatin Dubravë Komuna e Suharekës dhe R.B. nga Suhareka, për shkak te shkeljes thelbësore te dispozitave te procedurës përmbarimore , konstatimit te gabuar apo jo te plotë te gjendjes faktike dhe zbatimit te gabuar te se drejtës materiale, me propozim qe gjykata e shkallës se dytë ta aprovoj ankesën e debitorëve ndërsa aktvendimin e atakuar ta anuloj duke e pranuar prapësimin e debitorëve dhe urdhrin përmbarimor ta anuloj.

Dhoma e Shkalles se Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e debitorëve është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Banka Credins sh.a, me seli ne Tiranë rr.”Vaso Pasha” nr.8 Republika e Shqipërisë, me datën 06.04.2021, ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorëve Shoqëria Tregtare N.T.P “Labi-Petroll” me nr. Biznesi 70065503, me adresë ne fshatin Dubravë Komuna e Suharekës, A.G. nga fshati Dubravë Komuna e Suharekës dhe R.B. nga Suhareka te cilët in përfaqëson sipas autorizimit Arlind Jupolli avokat nga Prishtina si dhe D.B. nga Suhareka, në bazë të dokumentit përmbarues: Kontrate Kredie Afatmesme nr.5525, nr.10788 Rep. dhe nr.3417 Kol., Kontratë për Hipotekën LRP.nr.4765/2015, ref.nr.1628/2015, dt.04.12.2015, Aktvendim mbi regjistrimin e Hipotekës nr.prot.06-637-2015 dt.04.12.2015, lëshuar nga Zyra Komunale e Kadastrit ne Malishevë, për shumën e detyrimit në vlerë totale prej 97,295.62 euro, me kamatë te rregullt dhe kamatëvonesë si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore, te gjitha këto ne afat prej 7 ditësh.

Ndaj urdhrin për përmbarim debitorët Shoqëria Tregtare N.T.P “Labi-Petroll” me nr. Biznesi 70065503, me adresë ne fshatin Dubravë Komuna e Suharekës dhe R.B. nga Suhareka, kane parashtruar prapësim me datën 23.04.2021, me pretendimin se urdhri përmbarimor bazohet ne dokument qe nuk ka tipare te përmbarueshmërisë, neni 71 pika 1.1 dhe 1.6 e LPP, shton se kreditori nuk ka bërë përpjekje qe ta bind debitorin për shlyerjen e tërësishme te detyrimit te mbetur me asnjë kërkesë te vetme marrë për bazë se kredia ne fillim ka qenë 400,000.00 euro e tani pagesa është ne shumen prej 97,295.62 euro, debitorët propozojnë qe gjykata ta shfuqizoj urdhrin përmbarimor si te kundërligjshëm dhe te pabazuar.

Përgjigje në prapësimin e debitorëve ka ushtruar kreditori, me datën 26.04.2021, me pretendimin se debitorët kanë paraqitur prapësim i cili është i pabazuar sepse nuk është

specifikuar asnjë dispozite e vetme nga debitorët. Propozimi për përmbarim është i rregullt ne kuptimin formal, dokumentacioni i bashkangjitur është ne pajtim me kërkesat ligjore dhe se prapësimi nuk mbështet ne andaj nga shkaqet e parapara me nenin 71 te LPP, andaj propozon qe gjykata ta refuzoj ne tërësi prapësimin e debitorëve, urdhrin përmbarimor ta vërtetoj dhe ti detyroj debitorët ne pagesën e shpenzimeve ne shumen prej 468 euro ne emër te tarifës se odes se avokateve për përgatitje te përgjigjes ne prapësim.

Gjykata Komerciale e Kosovës- Dhomat e Shkalles se Parë, pas vlerësimit te prapësimit dhe përgjigjes ne prapësim, ka refuzuar prapësimin e debitorëve si te pabazuar dhe ka obliguar debitorët ne pagesën e shpenzimeve prej 468 euro. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka vlerësuar dokumentet përmbarimore mbi bazën e te cilave është lejuar përmbarimi se te njëjtat përbejnë bazë juridike për caktimin e përmbarimit ngase i kane plotësuar kushtet ligjore nga neni 27 i LPP për te qenë te përmbarueshme dhe njëkohësisht te përshtatshme për përmbarim. Pretendimet e debitorëve i ka vlerësuar si te pabazuara dhe te paargumentuara ne prova konkretë ngase Kontrata për Hipotekën është e regjistruar me Aktvendimin mbi regjistrimin Hipotekës nr.06-637-2015 dt.04.12.2015. Gjykata analizoi pretendimet e debitorëve dhe shkresat e lendes dhe vlerësoi se nuk është përmbushur asnjë nga kushtet ligjore për anulimin e urdhrin përmbarimor ndërsa ne lidhje me shpenzimet e procedurës sipas kërkesës e palës ka vendosur konform nenit 17 te LPP dhe nenit 450 dhe 452.1 te LPK duke vendosur se debitorët ne mënyrë solidare ti paguajnë këto shpenzime ne shume prej 468.00 euro.

Gjykata Komerciale -Dhomat e shkalles se Dytë, qëndrimin dhe përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë nuk mund ta përkrah si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar është përfshirë ne shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 te LPK-së dhe në vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 183 të LPK-së.

Kjo gjykatë vlerëson se Gjykata e shkalles se parë nuk ka analizuar saktë dhe drejtë gjendjen e fakteve me rastin vendosjes sepse e njëjta nuk ka trajtuar me kujdes te gjitha pretendimet e debitorëve mbi çështjen ne procedurë. Kështu gjykata e shkalles se parë ne aktvendimin e saj shprehet se ka vlerësuar se pretendimet e debitorëve ne prapësim e te cilat sipas saj janë te paqëndrueshme dhe te pabazuara ne ligj, por e njëjta gjykatë nuk ka trajtuar pretendimin e debitorëve sa i përket parashkrimit i cili pretendim i tillë ka qenë edhe pretendim i prapësimit, me ç ‘rast me qellim te konstatimit te faktit se ka pasur apo jo parashkrim ne rastin konkret te çështjes, ka pasur mundësi te kërkoj nga debitorët se ne cilat prova konkrete mbështetën te njëjtit për një pretendim te tillë, e qe nga provat ne lende rezulton se gjykata e shkallës se parë fare nuk është lëshuar ne këtë aspekt. Mbi bazën e këtyre arsyeve gjykata e shkallës së dytë vlerëson se me qellim te analizimit edhe një herë te çështjes, sqarimit dhe konstatimit te saktë te gjendjes se fakteve ne raport me pretendimin e debitorëve e ne këtë rast konkret për parashkrim e pretenduar te detyrimit, gjykata e shkallës se dytë vlerëson se aktvendimi i ankimuar duhet të anulohet dhe çështja të kthehet në procedim të serishëm në gjykatën e shkallës së parë dhe se gjykata e shkalles se parë mund te hap seancë dëgjimore konform nenit 73 paragrafi 1 të LPP-së, i cili thotë, se: *“Gjykata mund të vendosë lidhur me prapësimin jashtë seancës gjyqësore. Përjashtimisht*

Gjykata mund të caktojë seancë publike nëse vlerëson se kjo është e domosdoshme për të kuptuar plotësisht validitetin e prapësimit. Gjykata do të njoftojë të gjitha palët për dëgjimin publik. Nëse Gjykata vendos të mbajë seancë dëgjimore publike, seanca dëgjimore do të mbahet brenda pesë (5) ditëve, kur kërkohet që përgjigjet ndaj prapësimit të pranohet nga gjykata”.

Në ri procedurë, gjykata e shkallës së parë duhet të ketë parasysh të gjeturat e gjykatës së shkallës së dytë, të vlerëson në mënyrë të drejtë gjendjen faktike, eventualisht të caktoj seancë dëgjimore në kuptim të dispozitave të lartcekura, në mënyrë që të ftohen palët ndërgjyqëse, të njëjtat të deklarohen rreth pretendimeve të tyre, të trajtohet çështja e parashkrimit të pretenduar nga debitorët në këtë çështje përmbarimore, duke argumentuar me prova konkrete, e më pastaj varësisht nga të gjeturat edhe të vendos konform dispozitave ligjore duke marrë aktvendim të drejtë dhe të ligjshëm.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,
Dhoma e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II nr.650/24, me datë 24.05.2024

Gjyqtari
Ramush Bardiqi